



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr 1805 Prot

Gramsh, më 19 /05/2021

URDHËR

Nr. 128 Dt. 19 05/2021

Për

“Lirimin e hapësirave dhe parkimeve publike të zëna nga automjete të dala jashtë përdorimit dhe automjetet funksionale të parkuara mbi 30 ditë”.

Për krijimin e një mjedisi të rregullt urban dhe funksional në shërbim të komunitetit, në zbatim të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015”Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 26, neni 64 i tij, Ligjit nr.10431, date 09.06.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.96, date 30.12.2019””Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore , administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative”i ndryshuar; Ligjit Nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për policinë bashkiake”,i ndryshuar;

URDHËROJ:

- I- Heqjen e automjeteve të dala jashtë përdorimit, automjeteve pa targa të parkuara në zonën urbane për shkak të zënies së parkimeve publike për një periudhë të gjatë duke shkaktuar problematika në parkimin e automjeteve të qytetarëve.
- II- Për automjetet në gjendje pune ,që janë të pajisura me targa dhe dokumentacionin përkatës, të cilat kanë qëndruar dhe qëndrojnë të parkuara në një afat mbi 30(tridhjetë) ditë të vilet tarifa prej 6000(gjashtë mijë)lekë, sipas përcaktimit të tarifave në VKB Nr.96, datë 30.12.2019 ,i ndryshuar.
- III- Afati për heqjen e automjeteve është 5 ditë nga marrja e njoftimit për lirim.
- IV- Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Policia Bashkiake, Sektori i Tatim-taksave si dhe Sektori i Shërbimeve me Sipërmarrje dhe Mjedisit.
- V- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
KLODIAN TAÇE

